

ALBANIAN LANGUAGE VERSUS GLOBALIZATION GJUHA SHQIPE PËRBALLË GLOBALIZIMIT

Hana DARDHISHTA¹

¹Fakulteti i Filologjisë - Universiteti i Tetovës
²e-mail: hana.dardhishta@unite.edu.mk

Përmbledhje

Sot globalizimi ka përfshirë të gjitha qytetërimet, të gjitha kulturat dhe shoqëritë. Sa i përket globalizimit, siç e dimë të gjithë ne, edhe pse i mbështetur në të ashtuquajturin liberalizim ekonomik, ai, mbi të gjitha, është një proces i lloj-llojshëm dhe kompleks. Themi kështu sepse llojllojshmëria dhe kompleksiteti i globalizimit rrjedhin nga kyçja e qytetërimeve të ndryshme e kjo nënkupton edhe kulturat e ndryshme në rrjedhat globale. Sa i përket trashëgimisë sonë kulturore, deri në kohën tonë vjen e ruajtur mirë, mirëpo, rrjedhat e përgjithshme globale, siç ndodh gjithkund në botë, nuk kursejnë as traditën tonë. Duke pasur parasysh që edhe gjuha është pjesë apo elementi më jetësor i kulturës sonë, në këtë punim shkencor do të trajtojmë çështjen e gjuhës shqipe apo gjuhës sonë përballë globalizimit.

Gjuhët përmes kontaktit me gjuhët dhe kulturat e tjera rrotull nesh, po japin e marrin sot mes tyre si kurrë ndonjëherë në historinë e njerëzimit, dhe kjo, para së gjithash, në saje të zhvillimit të jashtëzakonshëm që kanë marrë teknologjitë e informacionit, këtu përfshihen edhe interneti, telefonia celulare, televizioni satelitor etj. Pra, duhet të jemi shumë të kujdesshëm në ruajtjen e asaj që është e jona, si gjuha ashtu edhe kultura në përgjithësi.

Fjalë kyçe: gjuha shqipe, globalizimi, huazime, teknologjia.

Abstract

Today, globalization involves all civilizations, all cultures and societies. As far as globalization is concerned, although it is based on the so called economic liberalization, we all know that it is above all a diverse process. We say so because the diversity and complexity of globalization derive from the involvement of different civilizations, which also refers to different cultures in global streams. Regarding our cultural heritage and tradition, it is well preserved so far, but, as it happens everywhere in the world, the general global trends are not sparing it. Having in mind that the language is the most vital part or element of our culture, this paper will deal with the issues of Albanian language, or our language, versus globalization.

Being in close contact with other languages and cultures around, languages themselves interact as they have never done before in human history, and this, above all, is due to the extraordinary development of the information technologies, including internet, mobile telephony, satellite television, etc. In conclusion, we have to be very careful in preserving of what is ours, both language and culture in general.

Keywords: Albanian language, globalization, loans,

Sot globalizimi na prek të gjithëve në mënyrë të drejtpërdrejtë. Në kuadër të procesit të zhvillimit të teknologjisë globalizimi ka krijuar sfida të shumta, siç është një proces zinxhir i ndryshimeve në fushën ekonomike, politike dhe kulturore të vendeve të botës. Për vendet të cilat përpiqen të ruajnë vlerat kulturore të tyre, njohja me pasojat dhe efektet e procesit të globalizimit është kthyer në një sfidë tepër të rëndësishme. Meqenëse, gjuha është pjesë e kulturës sonë, këtë herë do ta trajtojmë çështjen e gjuhës shqipe përballë globalizimit. Siç e dimë të gjithë ne, që

gjuha përveçse përdoret për të komunikuar, gjuha gjithashtu është një reflektim i kulturës së një populli, prandaj themi që gjuha përfaqëson identitetin e atij populli dhe botën e tij. Nga ana tjetër kemi globalizimin i cili synon unifikimin e botës në një gjuhë dhe një kulturë (në përgjithësi ky unifikim bëhet kryesisht përmes gjuhës angleze) që nënkupton anashkalimin e gjuhëve amtare. Sa i përket ekzistencës së një gjuhe unike për komunikim mes popujve në disa aspekte është shumë pozitive, sepse kjo metodë u mundëson të gjithë popujve të botës që të komunikojnë me një lehtësi mes tyre dhe kështu të eliminojnë distancat. Por, nga ana tjetër duhet të jemi shumë të kujdesshëm në ruajtjen e asaj që është e jona, si gjuha ashtu edhe kultura në përgjithësi.

Në gjuhën shqipe, ashtu si edhe në çdo gjuhë (zakonisht përmes kontaktit me gjuhët e tjera dhe kulturat e tjera) janë prezente shumë huazime, kjo, para së gjithash, sot ndodh në saje të zhvillimit të jashtëzakonshëm që kanë marrë teknologjitë e informacionit. Kështu, kuptohet që nuk ka barrierë të pengojë qarkullimin e lirë të ideve e të fjalëve. Zhvillimi i teknikës dhe i teknologjisë është një prej karakteristikave kryesore të globalizimit. Pa një zbatim të teknologjisë së lartë, bota sot nuk do të kishte këtë nivel të zhvillimit ekonomik, të standardit jetësor dhe të civilizimit. Gjuhëtari e filozofi i njohur, Ferdinand de Sosyri, duke përkufizuar gjuhën si të paprekshme, por jo edhe të pandryshueshme, paraqet konceptin e tij mbi ndryshimin gjuhësor si dukuri e vetvetishme. Në kontekst të kësaj mund të përmendim edhe risitë tekniko-shkencore dhe ato në jetën shoqërore në përgjithësi. Padyshim që kanë nxitur dhe nxisin nevojën e krijimit të fjalëve e të shprehjeve të reja në gjuhë, por edhe të futjes e pastaj edhe përhapjes së termave shkencorë dhe teknikë ndërkombëtarë.

Gjuha shqipe, në bazë të shumë studimeve gjuhësore, del se i ka rezistuar asimilimit nga gjuhët e huaja. Duke shikuar gjendjen e gjuhës shqipe sot, kuptojmë që në gjuhën shqipe kemi një vërshim të fjalëve të huaja për shkak të kontaktit të drejtpërdrejtë të shqiptarëve me gjuhët e huaja, tani më jo thjeshtë kontakti me gjuhët e huaja vetëm në shkollë, por gjithandej. Në këto rrethana, pra kur kontakti i drejtpërdrejtë i shqiptarëve me gjuhët e huaja sollti një vërshim të fjalëve të huaja në gjuhën shqipe, ndalemi dhe mendojmë edhe për historikun e gjuhës. Historia na tregon që ne si popull kemi qenë në fqinjësi me popuj tjerë por edhe nën sundimin e të tjerëve, dhe në kushte të tilla një popull është në kontakt edhe me popuj tjerë, e kështu edhe me gjuhë të ndryshme dhe në këto rrethana historike është normale që të ketë edhe pranim të fjalëve të huaja. Por, ka rëndësi që kjo gjuhë të ruaj palcën e saj apo më mirë thënë strukturën e saj. Pra, në qoftë se struktura e një gjuhe ruhet atëherë nuk ka nevojë për një shqetësim të madh. Edhe rilindasit tanë ishin shumë të shqetësuar për turqizmat që hynë në gjuhën shqipe, e sidomos në shqipen e shkruar. Ata ishin të interesuar të kishim një gjuhë shqipe të shkruar pa praninë e madhe të turqizmeve që ishin prezente në gjuhën e folur, edhe aty ku nuk ishte nevoja e tyre. Ky kujdes duhet të jetë edhe sot te gjuha standarde apo gjuha letrare, gjuha e shkencës, e mjeteve të komunikimit.

Kështu, edhe sot ky realitet i ri e vuri shqipen përballë një ballafaqimi dhe bashkekzistence jo më vetëm me gjuhët regjionale (siç është maqedonishtja për ne këtu në Republikën e Maqedonisë së Veriut, për shqiptarët e Kosovës deri vonë ishte serbishtja, për të tjerët që sot jetojnë jashtë trojeve shqiptare, për dikë italishtja, për dikë tjetër gjermanishtja apo frëngjishtja e shumë gjuhë të tjera) por me një gjuhë që sot u prin proceseve globalizuese botërore, siç është anglishtja. Ndryshimeve shoqërore në përgjithësi së pari u ekspozohen të rinjtë, edhe atë në aspekte të ndryshme. Këtë trajtesë e kemi bërë duke bërë anketime, vëzhgime dhe interpretime për ndikimin e gjuhës angleze drejtpërdrejt në gjuhën shqipe, si dhe përdorimin e saj të panevojshëm edhe në ato raste ku duhet të përdoret fjala shqipe në vend të fjalës së huaj. Kështu në vijim do të shtjellojmë disa konstatime nëpërmjet shembujve të ndryshëm:

- **Teknologjia.** Të gjithë jemi dëshmitarë të asaj që gjuha angleze është duke krijuar fjalë të reja me një ritëm që vështirë e kanë ta ndjekin gjuhët e tjera, ndaj duhet të marrin mjaft fjalë nga ajo nëse dëshirojnë të jenë në hap me shkencën, teknikën, teknologjinë e ekonominë e përparuar të botës. Sidomos sot në botën e teknologjisë, të njëjtat fjalë përdoren në të gjithë botën si terma teknologjikë. Kjo terminologji tashmë është e përfshirë në bisedat e përditshme dhe lë vend për analiza gjuhësore shtesë mbi këtë temë. Sektori i teknologjisë po lulëzon e këtë gjë mund ta keni vënë re të gjithë ju fare mirë edhe atë përmes celularëve, tabletëve, shërbimeve online etj. Si rezultat i kësaj, aftësitë dhe gjuhët e programimit po bëhen gjithmonë e më të rëndësishme. Prurjet e reja si në këto lëmi janë aq të shpeshta sa që nuk mund të paramendohet komunikimi mes dy studentëve të programimit pa përdorimin e fjalëve të ndryshme nga gjuha angleze. Në përputhje me tendencat globale të teknologjisë informatike, mësimi i gjuhëve të huaja të programimit është gjithashtu i rëndësishëm për të qenë në përputhje me zhvillimet më të fundit në fushën e zhvillimit të rrjeteve kompjuterike dhe të dhënave. Mungesa e fjalëve në gjuhën shqipe, sidomos për sfera të ndryshme profesionale, si: *kompjuter, monitor, skaner, celular* e shumë e shumë të tjera, numri i të cilave nuk dihet saktësisht, apo edhe *software, hardware, server* etj., ka bërë që këtyre fjalëve zor se mund t'u gjenden gjegjëset e tyre në gjuhën shqipe prandaj hyjnë në gjuhë së bashku me nocionet. Pra, shumica e fjalëve dhe terminologjisë në teknologjinë informatike janë të huazuara nga anglishtja dhe përdoren globalisht dhe kjo vjen si rezultat i ndikimit të teknologjisë nga vendet anglofone. Përdorimi i kësaj teknologjie e me këtë edhe emërtimet e saj, konsiderohet si kusht kryesor për funksionimin e një bashkësie shoqërore, ashtu siç mund të konsiderohen edhe sot gjuhët programuese. Pra, anglishtja përdoret si gjuhë e komunikimit për shkak të universalitetit dhe përdorimit të gjerë në botën e teknologjisë informatike.
- **Gjuha e programimit.** Parashtrohet pyetja, çfarë na qenka gjuha e programimit? Është gjuhë e cila përmban një bashkësi të rregullave me anë të cilave urdhërohen kompjuterët ose më mirë thënë u jepen udhëzime. Gjuhët programore si *Java, C++* e shumë të tjera, janë të krijuara në gjuhën angleze, siç i kanë komandat e tyre fillestare me shprehje në gjuhën angleze, p. sh.: *if (a>2) then a=3*, ku *if* dhe *then* janë fjalë që prej gjuhës angleze përkthehen: nëse ($a > 2$) atëherë $a = 3$; pastaj kemi *else* (përndryshe); *do* (bëj), *while* (ndërkohë që) etj. Fëmijët apo nxënësit, të cilët ndjekin kurse të ndryshme në shkollat e ndryshme digjitale, ku mësimi përveç që realizohet në gjuhën shqipe e në disa shkolla edhe në gjuhën maqedonase, janë shkolla private që bëjnë edukimin e gjeneratave të reja në fushën e programimit. Zhvillimi i orës mësimore bëhet në gjuhën shqipe por punohet me një gjuhë programuese e cila është krijuar në gjuhën angleze. Testimet si ato vendore edhe ato regjionale realizohen po në gjuhën angleze. Në këto raste, nëse një nxënës është i mirë në programim por nuk është edhe aq i mirë në gjuhën angleze, sigurisht nuk do të arrijë rezultatet e dëshiruara, pikërisht nga mungesa e njohurive të gjuhës. Prandaj, njohja e anglishtes është një aftësi kyçe dhe e nevojshme. Por, kjo çështje nuk është shqetësuese, sepse shqiptarët shquhen për aftësinë e të mësuarit gjuhë të huaja, por shqetësues është fakti kur lëmë anash fjalët e shqipes dhe fusim në përdorim fjalë të anglishtes.

- **Interneti.** Përdorimi i anglicizmave në rrjetet sociale, të cilat janë bërë pjesë e pandashme e përditshmërisë sonë që njëkohësisht na ka futur në botën virtuale globale. Depërtimi i fjalëve të huaja bëhet në mënyra të ndryshme, por ajo që është më e dhimbshme për gjuhën shqipe janë rastet kur shohim tek të rinjtë që në komunikimin e përditshëm të tyre (si komunikimi në rrjetet sociale ashtu edhe në jetën e përditshme, pra si në të shkruar ashtu edhe në të folur) bëhet përzgjedhja e anglicizmave në vend të fjalëve shqipe. Kemi të bëjmë, si për shembull me disa reklama në rrjetet sociale (që shërbejnë për bizneset private, të cilat biznese, duke dashur të jenë më të kërkuar në treg, apo ndoshta edhe me qëllimin që të jenë më në hap me kohën dhe me gjeneratat e reja) që gjatë reklamimit të produktit përdoren fjalë të huaja apo anglicizma si mjet identifikimi me të renë dhe përparimtarë, e që në fakt kjo, e dëmton dhe e bastardon gjuhën shqipe, si: Në *Blue Lounge*, ...deodoranti *sweet pitt* ka qenë ndër produktet *best seller* të verës...; S. M. ka ndar me ne *eksperiencën* dhe *review* e saj me setin *blue shine*; Ky larës fytyre pastron çdo papastërti si dhe *makeup-in*¹ që është...; *bio care* apo kremërat *my beauty*. Më tutje kemi shembullin: ...*balmi* për buzë të hidratuara (duhet: balsami, kjo mendohet ta ketë emërtimin nga lulja e balsamit *Hypericum perforatum*, *H vulgare*, *H. Calendula officinalis*². Tek bimësia zakonisht emërtimet përdoren në gjuhën latine, edhe pse gjuha shqipe është shumë e begatë në këtë fushë, në rastin konkret kemi fjalën verdashka për *Calendula officinalis*, gjithashtu edhe emërtimet tjera në rajone të ndryshme shqipfolëse si, kumaku, mergjyli, mërgjyzja, nargjileçka.³
- **Mediet.** Nuk duhet lënë pa përmendur edhe rrugët tjera si mediet elektronike, duke filluar që nga emërtimi i disa shtëpive informative po në gjuhë të huaj, pastaj duke vazhduar më pas edhe me vetë punonjësit e medieve apo më mirë thënë folësit e radios dhe të televizionit, të cilët në fjalorin e tyre kanë shumë fjalë të huaja, si: *impenjim total - përkushtim i plotë; surprizoj – befasoj; relaksoj – pushoj; dedikoj – kushtoj; prioritet – përparësi* etj. Nuk ka dhe nuk mund të ketë medie të zhvilluara e të përparuara pa gjuhë të përpunuar, pa kujdes e punë të përkushtuar për ta gjetur e përdorur fjalën e terminologjinë e shqipes në mënyrën e duhur. Punonjësit e medieve janë përhapës dhe përçues të gjuhës së shkruar dhe të gjuhës së folur standarde. Por, sot ka medie që nuk bëjnë aq sa duhet për gjuhën shqipe.
- **Komunikimi në administratë.** Ndikimi i anglishtes në gjuhën shqipe vërehet edhe tek punonjësit e administratës dhe është një çështje që duhet të merremi me të, duke përfshirë këtu sidomos terminologjinë e teknologjisë, sepse është një terminologji shumë e rëndësishme, që tërë kohën është në përdorim e nga ana tjetër nuk merremi me këto problematika, p. sh. shpesh herë nga punonjës të ndryshëm nëpër sportele të administratës mund të dëgjojmë që për mbylljen e një dokumenti thuhet: bëj *cancel* ose *cancel*-oj për: mbyll; pastaj *klik*-oj apo bëj *save* për: ruaj etj. Këto e shumë fjalë të tjera edhe mund të shmangen lehtë nga përdorimi.
- **Muzika.** Rrymat moderne muzikore, ndikojnë drejtpërdrejtë në fjalorin e përditshëm të të rinjve, duke u përhapur më vonë edhe në mjedise më të gjera. Tekstet e këngëve janë një

¹ Shembujt e pikës së tretë janë marrë nga rrjetet e ndryshme sociale.

² Lloshi, Xhevat, Fjalor i emrave të bimëve dhe të kafshëve shqip-latinisht dhe latinisht-shqip, Logos – A, Shkup, 2010, f. 192.

³ Po aty, f. 350.

përzierje kodesh, me tekst të përzier, pak fjalë në gjuhën shqipe dhe pak fjalë nga anglishtja apo pak fjalë në gjuhën shqipe dhe pak fjalë nga gjuha frënge apo gjuha gjermane, e që bëhet me të vetmin qëllim, efektin stilistik.

Globalizmi po sjell sfida për ruajtjen dhe zhvillimin e gjuhës shqipe. Pra, kujdes i veçantë duhet t'i kushtohet depërtimit të fjalëve të huaja të cilat janë të panevojshme për shqipen. Numri i folësve dygjuhësh apo edhe shumëgjuhësh ka shtuar mundësinë që secili folës të përdorë fjalë të gjuhëve të huaja paralelisht me fjalët e shqipes apo ta heqin fjalën e shqipes duke parapëlqyer fjalën e huaj, p. sh.: bëj *shopping* - bëj pazar; jemi bërë *bowring* - jemi bërë të mërzitshëm, *casual* – shprehje për veshje, për stil, modë etj.

Nga shembujt e mësipërm vërejmë që sferat në të cilat folësit janë më dinamikë dhe kreativë janë: teknologjia kompjuterike dhe interneti, më pas sfera argëtuese, më konkretisht muzika, por duke mos lënë anash edhe fjalë e shprehje të huaja që përdoren në fjalorin e jetës së përditshme. Kontakti me anglishten në të gjitha këto sfera është i menjëhershëm dhe depërtimi i anglicizmave në gjuhën shqipe ndodh drejtpërdrejt. Nëse deri dje parashtronim pyetjen se si mund të përballohet kjo situatë dhe çfarë qëndrimi duhet mbajtur ndaj huazimeve leksikore të kohës, sot jemi në një gjendje ku jemi dëshmitarë që tek gjeneratat e reja tani më nuk bëhet fjalë vetëm për huazime leksikore por kemi kaluar në biseda e shprehje me përmbajtje më të gjera.

Zëvendësimi i fjalëve të huaja me fjalë shqipe do të ishte zgjidhja më e mirë e kësaj çështjeje, por çështja është se sa kjo respektohet dhe nga cilat shtresa. Duhet theksuar edhe atë, që në botën globale, fjalët e huaja herë pas here janë të nevojshme, por ato duhet të përdoren me formën dhe kuptimin e duhur, aty ku ka vend, dhe në masën e nevojshme. Gjithashtu një çështje që duhet trajtuar e diskutuar është edhe çështja e disa fjalëve të huaja të cilat sot për sot nuk mund të zëvendësohen me fjalë të gjuhës shqipe, se si këto fjalë do të depërtojnë në gjuhën shqipe të shkruar.

Kështu vijmë në përfundim që globalizmi ka një ndikim të madh në gjuhën shqipe dhe jo vetëm, pra, ky ndikim është prezent edhe te gjuhët e kombeve tjera. Për shkak të dominimit global të anglishtes si gjuhë e komunikimit ndërkombëtar, shumë fjalë dhe shprehje anglisht janë futur në gjuhën shqipe, ndikim ky i cili ka ardhur në disa mënyra, si në mbarë botën ashtu edhe tek ne:

- përdorimi i anglishtes si gjuhë e komunikimit ndërkombëtar ka sjellë ndikimin e fjalëve dhe shprehjeve anglisht në gjuhën shqipe;
- zhvillimi i internetit, që ka hapur rrugën për komunikimin global dhe shkëmbimin e informacionit në mënyrë të shpejtë;
- shumë fjalë anglisht janë futur në gjuhën shqipe, sidomos në fushën e teknologjisë dhe biznesit. Terminologjia e teknologjisë po fiton gjithnjë e më shumë rëndësi, për shkak të zhvillimit teknologjik dhe numrit në rritje të përdoruesve të pajisjeve elektronike në të gjithë botën;
- anglishtja dhe fusha e teknologjisë informatike kanë një lidhje të fortë pasi anglishtja është gjuha dominuese në këtë fushë. Kjo mund të jetë sfiduese për ata që kanë njohuri të kufizuara të gjuhëve të huaja.

Rezultatet e globalizimit në gjuhë qëndrojnë në atë se ç'bëjmë ne me to? Si sillemi ne ndaj këtyre prurjeve? Këto prurje e vënë shqipen vijimisht në sprovë për të zgjuar vetveten, duke i kushtuar rëndësi kultivimit dhe ruajtjes së pastërtisë së gjuhës shqipe. Të gjitha këto fjalë dhe shumë të tjera që nuk janë përmendur kanë nevojë për një shqyrtim teorik. Ato të cilat do të duhet

të përfshihen në fjalorin e gjuhës shqipe së pari duhet të përcaktohet fjalësi në bazë të parimit të drejtshkrimit.

Gjithashtu ne nuk duhet të lejojmë me çdo kusht nxjerrjen e fjalëve të huaja nga përdorimi edhe kur ato janë të nevojshme, sepse huazimet konsiderohen si proces i natyrshëm dhe i pandalshëm, kjo, siç dihet nga mungesa e fjalës ose e shprehjes për nocione apo objekte të caktuara, e sidomos në këtë kohë të zhvillimit të teknologjisë dhe të fushave tjera shkencore. Por, kjo nuk do të thotë se duhet t'i përbuzim dhe përjashtojmë fjalët tona aty ku i kemi. Kujdes i veçantë duhet t'i kushtohet pengimit të depërtimit të fjalëve të panevojshme për të cilat ekziston fjala shqipe. Rezistenca ndaj huazimeve nuk ka ndaluar dhe gjithmonë ka qenë element përbërës i zhvillimit të gjuhës shqipe. Pasi që kemi bërë një elaborim të shkurtër të kësaj teme, po sjellim në kujtesë disa fjalë të vyera, nga gjuhëtari i mirënjohur Xhevat Lloshi, i cili thekson: "Duhet të mësohemi të jetojmë në një botë shumëgjuhëshe, duke ruajtur identitetin tonë dhe gjuhën tonë të shtrenjtë"⁴. Pra, dihet se në botë nuk ka gjuhë pa huazime, por çdo gjuhë duhet të përpiqet ta ruajë brumin e vet, duke mos shmangur çdo gjë që vjen nga jashtë, por as duke pranuar në mënyrë jokritike çdo risi. Kjo ka të bëjë me ngritjen e kulturës në përgjithësi dhe me ngritjen e kulturës së gjuhës në veçanti.

Bibliografia:

- [1]. Caka, Nebi, *Disa aspekte të përgjithshme të hartimit të një fjalori të informatikës në gjuhën shqipe*, Prishtinë, 2000.
- [2]. Caka, Nebi, Dika, A., Rodiqi, S., *Fjalor i informatikës*, (anglisht-shqip; shqip-anglisht), Prishtinë, 2005.
- [3]. Caka, Nebi, Caka, Ali, *Korpusi i gjuhës shqipe – rezultatet e para, problemet dhe detyrat*, ASHAK dhe ASHSH, Prishtinë, 2011.
- [4]. Caka, Nebi, Susuri, Latif, *Standardizimi dhe normëzimi i terminologjisë shkencore dhe profesionale*, Prishtinë, 2009.
- [5]. Caka, Nebi, *Shqipërimi i disa termave të informatikës*, Koha ditore, nr. 2612, Prishtinë, 2004.
- [6]. Gjovalin Shkurtaç, *Kahe dhe dukuri të kulturës së gjuhës shqipe*, Tiranë, 2003
- [7]. Jani Thomai, *Leksikologjia e gjuhës shqipe*, Toena, Tiranë, 2006
- [8]. Lloshi, Xhevat, *E duam drejtshkrimin si gjithë Europa*, Shkup, 2022.
- [9]. Lloshi, Xhevat, *Propozime për drejtshkrimin I-II (1976-2014)*, Shkup, 2022.
- [10]. Lloshi, Xhevat, *Shqipja – gjuhë e hapur dhe dinamike*, Onufri, Tiranë, 2013.
- [11]. Rrokaj, Shezai, *Filozofi e gjuhës – prej Antikitetit deri në kohën e sotme*, Arbëria, Tiranë, 2010.
- [12]. <https://www.scribd.com/document/Dejvid-Kristal-Smrt-Jezika>

⁴ Lloshi, Xhevat, *E duam drejtshkrimin si gjithë Europa*, Shkup, 2022, f. 183.